



**Republika e Kosovës**

**Република Косово / Republic of Kosovo**

**Qeveria / Влада/ Government**

*Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Ministry of  
Communities and Return*

**STRATEGJIA PER KOMUNITETE DHE KTHIM**

**2014 - 2018**

**Prishtinë  
Dhjetor, 2013**

**TABELA E PËRMBAJTJES**

SHKURTESAT .....	3
DEFINICIONET .....	4
A. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	6
B. HYRJE.....	7
C. METODOLOGJIA .....	9
D. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONET PËRKATËSE.....	10
D1. KORNIZA LIGJORE .....	10
D2. INSTITUCIONET PËRKATËSE.....	10
E. SFONDI .....	12
E1. Analiza e gjendjes aktuale e komuniteteve dhe e kthimit në Kosovë .....	12
E2. Numri i kthimeve vullnetare .....	12
E3. Shtëpitë e ndërtuara dhe të banuara gjatë periudhës 2009-2013 .....	13
E4. Qendrat kolektive.....	13
E5. Fondet e shpërndara për procesin e kthimit .....	14
E6. Projekte të zbatuara nga agjensi të tjera qeveritare .....	15
E.7. Palët me interes .....	16
E8. Sfidat dhe problemet e identifikuar.....	18
E9. Masat e rekomanduara.....	18
F. OBJEKTIVAT .....	19
G. ALTERNATIVAT E KONSIDERUARA .....	23
H. QASJA E REKOMANDUAR.....	24
I. HAPAT E ARDHSHËM.....	26
J. SHTOJCAT .....	26
Shtojca A - Plani i Veprimit.....	26
Shtojca B - Instrumentet Ligjore .....	26

## SHKURTESAT

ABB	Ambasada e Britanisë së Bashkuar
AMN	Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë
ASHBA	Ambasada e SHBA-së
AZ	Ambasada e Zvicrës
BE	Bashkimi Evropian
BPRM	Departamenti i Shtetit SHBA, Byroja për popullësi, refugjatë dhe migracion
CDF	Programi i Aftesimit të Kuadrove
CRPK	Programi për të Drejtat Civile Kosovë
DRC	Këshilli Danez për Refugjatë
ECMI	European Center for Minority Issues
GPR	Grupi Punues Rajonal
GPK	Grupi Punues Komunal
GIZ	Zyra Gjermane për Bshkëpunim Ndërkombëtarë
IE	Integrimi Evropian
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Këshilli i Evropës
KKK	Këshilli Konsultativ për Komunitete
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MAP	Ministria e Administrates Publike
MAPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MAPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
ML	Ministrit e Linjës
MF	Ministria e Financave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
PZH	Personat e Zhvendosur

PZhBV	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
PZHR	Personat e Zhvendosur në Rajon
UNHCR	Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurisë Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencioni për Zhvillim Ndërkombëtarë i SHBA-së
VShI	Vizita "Shko - dhe -informo"
VShSh	Vizita "Shko - dhe - shiko"
ZBEK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik
ZÇK	Zyra për Çështje të Komuniteteve

## DEFINICIONET

**Kategoritë e personave të zhvendosur** - Shpjegimi i kategorive të ndryshme të personave të zhvendosur janë të rëndësishme kur vjen fjala për trajtimin e çështjeve të tyre, prandaj personat e zhvendosur nga Kosova janë të ndarë në kategoritë e mëposhtme:

**Personat e Zhvendosur Brenda Vendit (PZHBV)** - Personat ose grupet e personave të cilët kanë qenë të detyruar të largohen ose të detyruar të lënë vendet e tyre të banimit të përhershëm në Kosovë ndërmjet janarit 1998 dhe në fund të marsit 2004, në veçanti, si rezultat ose në mënyrë që t'i shmangen efekteve të konfliktit të armatosur, situatës së dhunës së përgjithshme, shkeljeve të të drejtave të njeriut, por mbeten brenda territorit të Kosovës.

**Personat e zhvendosur në rajon (PZHR) (Serbi, Mali i Zi, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë), Bosnje dhe Hercegovinë, dhe Kroaci** - Personat ose grupet e personave të cilët kanë qenë të detyruar ose të detyruar të ikin apo për të lënë vendet e tyre të banimit të përhershëm në Kosovë ndërmjet janarit 1998 dhe në fund të marsit 2004, në veçanti, si rezultat ose në mënyrë që t'i shmangen efekteve të konfliktit të armatosur, situatës së dhunës së përgjithshme, shkeljet të të drejtave të njeriut, dhe mbeten jashtë territorit të Kosovës, përkatësisht në rajon.

**Refugjatët (R) nga Bosnje dhe Hercegovinë, dhe Kroaci** - Personat e vendosur jashtë kufinjëve të shtetit të tyre vendor, apo vendqëndrimin, të cilët kanë frikë nga persekutimi, si pasojë e konfliktit 1992-1995, për shkak të racës së tyre, religjionit, nacionalitetit, përkatësisë në ndonjë grup shoqëror, apo të ndonjë opinionit politik, dhe të cilët nuk dëshirojnë të mbrohen nga shteti, apo të kthehen për shkak të frikës nga persekutimi, dhuna dhe kërcënimet nga etnitetet dhe individët e ndryshëm.

**Kthimi spontan (grupe individuale dhe të vogla)** - Individët, familjet ose grupet të cilët janë kthyer pa ndonjë paralajmërim paraprak dhe nuk marrin asnjë ndihmë materiale para kthimit të tyre ose nuk kanë planifikuar kthimin e tyre më herët.

**Kthimi i Ndhmuar** - Bazuar në kërkesat individuale nga personat e zhvendosur, familjet ose grupe relativisht të vogla të të kthyerve, asistenca u ofrohet para, gjatë dhe pas kthimit, zakonisht përmes komunave apo OJQ-ve përmes programeve tashmë të përcaktuara.

## A. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014-2018 (në tekstin e mëtejshëm “Strategjia”), e cila është udhëhequr nga vizioni i një shoqërie shumetnike të Republikës së Kosovës, është një kontribut i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (në tekstin e mëtejshëm “MKK”) drejt një shoqërie demokratike me të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e saj.

MKK, sipas mandatit të saj në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë së Kosovës, synon të arrijë kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur brenda dhe jashtë vendit dhe të riintegrimin dhe stabilizimit të suksesshëm të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Në vazhdimësi të strategjisë së periudhës 2009-2013, MKK harton këtë dokument të ri strategjik që të shërbej si udhërrëfyes gjatë procesit të kthimit i cili përfshin jo vetëm ndërtimin e njëjësive të banimit por edhe çështjen e qasjes në shërbimet publike si: marrjen e dokumenteve personale, shërbimet mjekësore; çështjen e sigurisë dhe lëvizjes së lirë, mundësinë e edukimit në gjuhën amtare, mundësinë e punësimit dhe qasje në infrastrukturë. Ky proces kërkon bashkëpunim dhe koordinim me institucionet relevante që mund të kontribuojnë në suksesin e procesit të kthimit dhe riintegrimin.

Strategjia përmban katër objektiva, të cilat MKK synon të realizojë gjatë pesë viteve të ardhshme 2014-2018:

Objektivat strategjike

1. Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit, personave të zhvendosur në: Serbi, Mal të Zi dhe IRJM;
2. Fuqizimi dhe stabilizimi i komuniteteve në Kosovë;
3. Hartimi dhe plotësimi i kornizës ligjore për komunitete, kthim dhe integrim,
4. Avancimi i sistemit të menaxhimit të brendshëm të MKK-ës,

Plani i Veprimit është zhvilluar në bazë të objektivave të përcaktuara (shih Shtojca A), në mënyrë të qartë thekson masa konkrete për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara për secilin objektiv. Në përmbajtje, Plani i Veprimit reflekton katër objektiva dhe nën - objektivat të cilat MKK-ja po planifikon të zbatojë, veprimet konkrete që shpiejnë në arritjen e objektivave; institucionet që duhet të përfshihen në procesin e kthimit, riintegrimin dhe stabilizimit të komuniteteve dhe përgjegjësitë e tyre (qasja në ofrimin e shërbimeve publike, përdorimi afatgjatë i ndihmës së ofruar si strehimi dhe ndihma socio - ekonomike); periudha e nevojshme e kohës për të arritur objektivat, burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve dhe treguesve të matshëm për të realizuar çdo objektiv.

MKK synon si më poshtë vizionin dhe misionin për të arritur objektivat e saj brenda periudhës 2014-2018:

#### **VIZIONI**

Të kontribuojë drejt zhvillimit të një shoqërie multietnike, demokratike, me prosperitet dhe të drejta të barabarta për të gjithë.

#### **MISIONI**

MKK është e përkushtuar drejt zhvillimit dhe zbatimit të politikave për zgjidhje afatgjata për PZH-të, të kthyerit dhe stabilizimin e komuniteteve. Prioritet tjetër është zhvillimi i një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe mbrojtja e të drejtave të PZH-ve në Kosovë dhe në rajon. MKK synon të fuqizojë procesin e kthimit edhe përmes themelimit të mekanizmit institucional të bashkëpunimit me Ministrinë e linjës, dhe partnerët rajonal dhe ndërkombëtarë.

## **B. HYRJE**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmes ligjeve përkatëse përcakton rolin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim si institucion bazë për përcaktimin e politikave në fushën e kthimit dhe komuniteteve.

Si rrjedhojë e perfundimit të strategjisë për periudhën 2009-2013, MKK ka identifikuar nevojën e hartimit të strategjisë së re për periudhën 2014-2018, që t'i adresoj nevojat e komuniteteve të cilëve i'u shërben në mënyrë të përkushtuar sipas përgjegjësive të dhëna nga mandati i saj.

Në bazë të së drejtës ndërkombëtare dhe kornizës ligjore të Republikës së Kosovës, personave të zhvendosur i'u garantohet e drejta për t'u kthyer në vendin e origjinës si dhe në vend tjetër përveç origjinës. MKK është e përkushtuar që t'i adresoj nevojat e personave të zhvendosur brenda dhe jashtë vendit, duke krijuar kushtet për kthim të qëndrueshëm dhe riintegrim të suksesshëm në shtetin multietnik të Kosovës. Kthimi është një proces kompleks i cili përveç ndërtimit të shtëpive përfshin lehtësimet për marrjen e dokumenteve të nevojshme, sigurinë dhe lirinë e lëvizjes, mundësinë e edukimit në gjuhën amëtare, shërbimet shëndetësore dhe mundësinë e punësimit. I tërë ky proces kërkon bashkëpunim dhe koordinim me institucionet përkatëse që mund të kontribuojnë në suksesin e procesit të kthimit dhe stabilizimit të komuniteteve.

Përgjegjësitë e dhëna Ministrisë për Komunitete dhe Kthim nga Qeveria e Republikës së Kosovës përfshijnë promovimin e një shoqërie multietnike në shtetin e Kosovës si mbështetje të drejtpërdrejtë ndaj procesit të integrimit Evropian.

MKK është e përkushtuar ndaj zhvillimit të politikave dhe zbatimit të ligjit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve si dhe mbështetjen e procesit të kthimit në

pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi. MKK është e përkushtuar ndaj praktikave transparente dhe luftës institucionale kundër korrupsionit.

Përmes këtij dokumenti strategjik, synohet të arrihen tre elemente kyçe: kthimi i qëndrueshëm, integrimin i të kthyerve dhe të zhvendosurve, dhe stabilizimi i komuniteteve. Qëllimi i kësaj strategjie është për të vendosur objektivat që do të udhëheqin planet afat gjata të MKK-së dhe aktivitetet e ardhshme për pesë (5) vite, me theksin mbi përgjegjësinë e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera të përfshira, dhe të rekomandojë sistemet për bashkëpunim të ndërsjellë me aktorët e përfshirë në procesin e kthimit dhe stabilizimit të komuniteteve.



## C. METODOLOGJIA

Në mënyrë që ky dokument i strategjisë të jetë plotësisht i zbatueshëm dhe të ofroj plane efektive konkrete të bashkëpunimit dhe koordinimit me të gjitha palët me interes vendore dhe ndërkombëtare, kështu që grupi i punës i përbërë nga zyrtarë të institucioneve të Kosovës dhe partnerët ndërkombëtarë, kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në shumë mënyra gjatë hartimit të strategjisë.

Institucionet dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare që kanë kontribuar në hartimin e kësaj strategjie janë Zyra e Planifikimit Strategjik/ZKM, ZÇK/ZKM, Këshilli konsultativ për Komunitete, Ministrinë e linjës, Ambasadat Norvegjeze dhe Britaneze me anë të mbështetjes financiare, Zyra e BE-së në Kosovë dhe Projekti i MKK-së, i implementuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) Projekti për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë (BE - RRRK 3), UNHCR, UNDP, USAID, OSBE, GIZ, dhe ECMI Kosova.

Procesi i hartimit të një strategjie të re, me formimin e një grupi punues nga Ministria për Komunitete dhe Kthim proces që përbëhet nga dy faza: A) Faza vlerësimit / hulumtimit dhe B) Faza e zhvillimit të strategjisë. Faza e parë është mbështetur nga Ambasada Norvegjeze dhe Britaneze përmes angazhimit të OJQ-ës, Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve - ECMI Kosovë e cila kreu hulumtime dhe përgatiti raportin mbi gjetjet e hulumtimit. Ndërsa në fazën e dytë, është formuar një ekip i përbërë nga zyrtarë të MKK-së të mbështetur nga përfaqësuesit e IOM-it dhe një këshilltar të jashtëm nga CDF-i.

Zhvillimi i strategjisë është bërë në bazë të Udhëzimit Administrativ 02/ 2012 mbi procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre. Gjithashtu, janë marrë parasysh rekomandimet / sugjerimet nga anëtarët e grupit punues dhe stafit të MKK-së.

MKK-ja vlerëson dhe çmon institucionet e nivelit qendror, partnerët vendor dhe ndërkombëtarë për kontributin e tyre në procesin e zhvillimit të Strategjisë 2014-2018.

## D. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONET PËRKATËSE

### D1. KORNIZA LIGJORE

Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës janë të garantuara me Kushtetutë, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, si dhe me anë të akteve ligjore ndërkombëtare (shih Shtojcën B). MKK, sipas legjislacionit në fuqi, vepron për të zbatuar procedurat për një jetë më të mirë dhe të mbështesë interesat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. MKK-ja, gjithashtu në mandatin e saj ligjor, vlerëson nevojat për nxjerrjen apo përmbushjen / ndryshimin e ligjeve dhe rregulloreve. Gjithë kuadri ligjor në fuqi në Republikën e Kosovës, garanton të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga raca, gjinia, perkatesia etnike, fetare, etj.

MKK konsideron të nevojshme nxjerrjen e kornizës ligjore për personat e zhvendosur brenda Kosovës.

Arsyet për nxjerrjen e kornizës ligjore janë: mungesa e instrumenteve juridike që mbulon këtë fushë; nevoja e pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare; duke i'u referuar parimeve udhëheqëse të KB-së për personat e zhvendosur brenda vendit; mungesa e regjistrimit dhe profilizimit të kësaj kategorie të popullsisë.

Nxjerrja e kornizës ligjore në fjalë do të ndikoj në sigurinë juridike, në situatat eventuale të zhvendosjes së popullsisë.

### D2. INSTITUCIONET PËRKATËSE

MKK synon të zbatojë Strategjinë 2014-2018, përmes autoriteteve të nivelit qendror dhe lokal, të cilat janë të përkrahura në këtë seksion.

Ministritë që janë të përfshira në procesin e kthimit dhe në riintegrimin e komuniteteve janë:

#### A. Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK);

MKK ka këto kompetenca<sup>1</sup>:

- „ Zhvillimin e politikave, promovimin dhe implementimin e legjislacionit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë të drejtën për t'u kthyer, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një strategjie qeveritare për mbështetjen e komuniteteve dhe mbështjen e zhvillimit dhe zbatimit të këtyre strategjive në të gjitha komunat ;
- Zhvillimin ose menaxhimin e programeve dhe mekanizmave për të lehtësuar integrimin në kushte të barabarta të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, të cilët aktualisht banojnë

<sup>1</sup> Për me shumë shih: Rregullorja nr. 02/2011 Për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive; shtojca nr.15 - Mandati i Ministries për Komunitete dhe Kthim; [http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/GZK\\_92\\_SHQIP.pdf](http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/GZK_92_SHQIP.pdf)

në Republikën e Kosovës, si dhe sigurimin e kthimit të qëndrueshëm të refugjatëve dhe personave të zhvendosur;

- Sigurimin që politikat në nivel qendror dhe komunal përfshijnë dispozita për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, të drejtave të njeriut dhe interesave të të kthyerve, duke përfshirë lirinë e lëvizjes , përdorimi i gjuhëve, lirisë së shprehjes, përfaqësimit të drejtë, arsimim, punësim dhe qasje të barabartë në drejtësi, strehimit dhe shërbimet publike dhe shërbimet komunale;...”.

Akterët tjerë të cilët direkt ose indirekt ndikojnë dhe përfshihen në procesin e kthimit dhe ri-integrimit të të kthyerve listohen si më poshtë:

## **2. Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK);**

Këshilli konsultativ për Komunitete vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet, i cili ofron një mekanizëm për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe ju ofron mundësinë komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legislative dhe politike, të cilat mundë të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse.<sup>2</sup>

## **3. Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK / ZKM);**

- “Kontribuon në koordinimin e punës së organeve qeveritare, agjencive dhe institucioneve të pavarura në nivel ministror dhe në nivel komunal;
- Kontribuon në koordinimin e punës së donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare për të siguruar që çështjet e komuniteteve të adresohen në mënyrë efektive në mbarë Kosovën. Eliminon përpjekjet e dyfishta dhe siguron përdorimin efektiv dhe të barabartë të shpërndarjes së fondit;
- Ndhmon në monitorimin e këtyre organeve, në sigurimin e kushteve që ata të kryejnë punën e tyre të përcaktuar në mënyrë efektive në lokacionet e vendosura në nivel të lartë”<sup>3</sup>.

## **4. Zyret Komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK).**

- Zyra identifikon, promovon, përkrahë, zbaton dhe mbikëqyrë politikat, aktivitetet dhe programet përkatëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve; qasjen e barabartë të komuniteteve në shërbime publike; krijimin e kushteve për kthimin e qëndrueshëm të refugjatëve, të të kthyerve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar.
- Zyra vepron në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe me politikat në fushën e promovimit të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siguron qasje të barabartë në shërbimet publike, krijim të kushteve për kthim dhe reintegrim të qëndrueshëm, përfshirë dokumentet strategjike të Qeverisë së Kosovës që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe

<sup>2</sup> <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=1,77> .

<sup>3</sup> <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=1,97> .

promovimin e të drejtave të komuniteteve, kthimin dhe riintegrimin e tyre.<sup>4</sup>

5. Ministria e Financave (MF);
6. Ministria e Integritit Evropian (MIE);
7. Ministria e Shëndetësisë (MSH);
8. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT);
9. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL);
10. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB);
11. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH);
12. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

## E. SFONDI

### E1. Analiza e gjendjes aktuale e komuniteteve dhe e kthimit në Kosovë

MKK ka implementuar një varg aktivitete dhe projektesh si pjesë e implementimit të strategjisë për komunitete dhe kthim 2009-2013.

Një numër i dokumenteve janë hartuar nga MKK-ja të tilla si: Rregulloret e brendshme, dhe Udhëzuesi për Mbështetje të Kthimit.

Dokumente të tjera janë hartuar nga Qeveria, të tilla si: Strategjia e qeverisë për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, si dhe politikat e qeverisë për komunitetet (shih Shtojcën B).

Gjatë periudhës 2009-2013 aktivitete të ndryshme treguan mbështetje për kthimin e komuniteteve në pajtim me informacionin e mëposhtëm:

### E2. Numri i kthimeve vullnetare

Tabelat e mëposhtme përfaqësojnë numrin e kthimeve vullnetare, siç raportohet nga ZKKK dhe UNHCR.

Tabela 1: Të kthyerit gjatë periudhës 2009-2013 (Raportuar nga ZKKK-të në Gusht 2013)

	2009	2010	2011	2012	2013	Totali
Shqiptarë	148	534	524	247	377	1830
Serb	249	394	392	567	353	1955
Boshnjakë	44	56	53	67	20	240

<sup>4</sup> Për me shumë shih: Rregullore Nr. 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim.

<b>Turq</b>	2	4	1	4	3	14
<b>Goran</b>	65	200	132	104	2	503
<b>Romë</b>	174	308	140	107	11	740
<b>Ashkali</b>	42	370	145	117	14	688
<b>Egjiptian</b>	71	114	60	62	0	307
<b>Të tjerë</b>	54	57	96	100	31	338
<b>Totali</b>	849	2037	1543	1375	811	6615

Sipas gjetjeve, në mesin e personave të zhvendosur disa nga problemet me procesin e kthimit janë: procesi i tejzgjatur i vendimmarrjes gjatë procesit të përzgjedhjes, mungesa e infrastrukturës, mbështetja institucionale (aspekti socio - ekonomik). Gjithashtu, në varësi të vendndodhjes së kthimit, ishin të theksuara çështjet e sigurisë për komunitetet që jetojnë në veri të Kosovës, dhe uzurpimi i pronave në veri dhe në disa vendodhje të kthimit.

### E3. Shtëpitë e ndërtuara dhe të banuara gjatë periudhës 2009-2013

Raportet e MKK-ës flasin për shifra të tilla si ndërtimi i 148 banesave, 557 shtëpive (të financuara nga MKK) dhe të 400 shtëpive (të financuara nga akterë të jashtëm, kryesisht si: BE dhe Ambasada Britanike) në periudhën kohore 2009-2013, shih tabelën më poshtë:

Tabela 2: Shtëpitë e ndërtuara dhe statusi banesor, Raport nga ZKKK

VITI I NDERTIMIT	2009	2010	2011	2012	2013	Totali
Totali i shtëpive të ndërtuara	229	238	265	247	120	972
Totali i shtëpive të banuara	118	134	191	203	90	651
Përqindja e shtëpive momentalisht të banuara	52%	56%	72%	91%	75%	67%

### E4. Qendrat kolektive

Gjatë periudhës 2009-2013 është bërë mbyllja e kampit të kontaminuar me plumb në Çesmin Llug, dhe e kampit në Osterode. Sipas të dhënave të UNHCR-së dhe ZKKK-ve, një numër i konsiderueshëm i të zhvendosurve vazhdon të jetoj në qendra kolektive, përkatësisht 930 PZhBV dhe refugjatë, ose 359 familje, shih më poshtë:

Tabela 3: Qendrat kolektive

Qendrat kolektive	Familje	Persona
TOTALI në Kosovë: 37 Qendra Kolektive	359	930

## E5. Fondet e shpërndara për procesin e kthimit

Buxheti i ndarë për MKK nga qeveria për periudhën 2009-2013, ka pasur një rënie prej 18 %.

MKK ka fuqizuar bashkëpunimin për të rritur fondet, me partnerët ndërkombëtarë siç janë: ZBEK, Ambasada e Britanisë së Bashkuar, USAID dhe të tjerë, për të siguruar fonde shtesë për implementimin e projekteve në funksion të kthimit dhe integritit të komuniteteve, sipas tabelës më poshtë:


Tabela 4: Ndarja e fondeve për procesin e kthimit

	2009	2010	2011	2012	2013
MKK-ja	8,707,057.00€	8,652,046.00€	7,160,317.00€	7,179,045.00€	7,179,045.00€
BE	<b>BE Mitrovicë Iniciativa e përkrahjes së Romë, Ashkali dhe Egjiptian</b>  <b>BE-MRSI I - Mbyllja e kampit Qesmin Llug dhe kampit Osterode</b>  <b>Shkurt 2010 - Dhjetor 2012</b>  <b>BE: € 5 mil, MKK: €0.1 mil</b>				2013-2015  Kthimi i Romëve, Ashkaliëve dhe Egjiptianëve  <b>BE: € 1.8 mil; MKK: 0.2 mil</b>
BE – RRK	RRK I: - qershor2008 –tetor 2010  <b>BE: 3.3 mil €; MKK 1.1 mil. €; UNDP: €0.4 mil.</b>	RRK II: gusht 2009 – korrik 2011;  <b>BE: 4 mil €; MKK 1.1 mil. €; DRC: 0.2 mil. €</b>	RRK III: nëntor 2011 – prill 2014;  <b>BE: 4 mil. €; MKK 1.1 mil. €; IOM 0.2 mil. €)</b>		
BE Stabilizimi i Komunitetit		CSP I: maj 2010 – maj 2012  <b>BE: 2 mil. €; MKK: 0.1 mil. €</b>		CSP II: korrik 2012 – dhjetor 2014 (vazhdon)  <b>BE: 3 mil. €; MKK: 1 mil. €</b>	
Departamenti Amerikan i Shtetit	<u>2009-2010</u> <b>849,985.00 \$</b>	<u>2010-2011</u> <b>467,999.00 \$</b>	<u>2011-2013</u> <b>400,567.00 \$</b>	<u>2012- 2013</u> <b>477,000.00 \$</b>	<u>2013-2014</u> <b>396,028.00 \$</b>
BPRM	<b>528,646.00 \$</b>			<b>700,000.00\$</b>	

Ambasada e Britanisë	2009-2010: <b>164,127 €</b>	2010-2011: <b>353,000 €</b>	2011-2012: <b>511,330 €</b>	2012-2013: <b>563,922 €</b>	2013-2014: <b>214,372 €</b>
----------------------	--------------------------------	--------------------------------	--------------------------------	--------------------------------	--------------------------------

MKK ka ofruar të dhënat mbi projektet e OJQ-ve të financuara nga ajo gjatë vitit 2012. Sipas këtyre të dhënave, MKK ka financuar OJQ-të me gjithsej €210,722,70. Këto fonde janë shpërndarë në 33 projekte të veçanta, nga të cilat katër kanë pasur vlerë prej më pak se €1,000, tetë me vlerë ndërmjet €1,000 dhe €5,000, dhe 21 prej tyre kanë pasur vlerë ndërmjet €5,000 dhe €10,000.

*Grafiku: Ndarja e fondeve për projektet e OJQ-ve në vitin 2012 sipas përkatësisë etnike*



MKK-ja gjithashtu ka ofruar të dhëna mbi projektet infrastrukturore gjatë periudhës 2010-2013. Sipas këtyre të dhënave, MKK ka financuar projekte infrastrukturore me vlerë mbi 5 milionë euro gjatë periudhës 2010-2013. Nga kjo shumë, pjesa më e madhe e fondeve është ndarë për aktivitetet që lidhen me ndërtimin e shtëpive, kurse 1.8 milionë euro të mbetur janë investuar në projekte që nuk lidhen me ndërtimin e shtëpive, si asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i objekteve sportive dhe rregullimi i sistemeve të ujërave të zeza.

## E6. Projekte të zbatuara nga agjensi të tjera qeveritare

Projektet në vijim janë raportuar nga agjencitë e tjera qeveritare që synojnë veçanërisht komunitetet pakicë:

- **Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK)** ka investuar mbi €4,503,032.41 për projekte që lidhen me infrastrukturën, arsimin, përkrahjen e shoqërisë civile dhe të projekteve të veçanta gjatë periudhës 2009-2013. Shihni një përmbledhje të projekteve, sipas kategorive, në vijim:
- **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal** ka përkrahur promovimin e të Drejtave të Komuniteteve në pjesën Veriore të Kosovës në vitin 2012, me €86,550.

### E.7. Palët me interes

Palët me interes janë shumë të rëndësishme në mbarëvajtjen dhe implementimin e aktiviteteve rreth komuniteteve dhe kthimit. Analiza më poshtë tregon se cilat janë ato palë, si vendore ashtu edhe rajonale dhe ndërkombëtare dhe çfarë niveli të rëndësisë kanë në raport me MKK-në:

Tabela 5: Institucionet vendore

Nr.	Palët me interes	Rëndësia
1	Zyra e Presidentes Këshilli konsulltativ për komunitete	Konsultimi lidhur me çështjet e komuniteteve
2	Parlamenti i Kosovës Komisioni për të drejtat e njeriut dhe komuniteteve	Konsultimi lidhur me miratimin dhe amendamentimin e kornizës ligjore
3	Zyra e Kryeministrit Zyra për çështje të komuniteteve	Bashkërendimi lidhur me politikat dhe projektet
4	Zyra e Kryeministrit Zyra për qeverisje të mirë	Bashkërendimi lidhur me politikat dhe projektet
5	Ombudspersoni i Kosovës	Bashkërendimi lidhur me të drejtat e komuniteteve
6	Auditori i përgjithshëm	Bashkërendimi lidhur me auditimin e brendshëm: performancën dhe financat
7	Ministria e financave	Bashkërendimi lidhur me financat e nevojshme
8	Ministria për zhvillim ekonomik	Bashkërendimi lidhur me zhvillimin ekonomik të komuniteteve
9	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Koordinimi rreth projekteve me komunat për bashkëfinancim
10	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Koordinimi rreth promovimit të punësimit dhe asistencës



11	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Bashkërendimi lidhur me arsimin
12	Ministria e Shëndetësisë	Bashkërendimi lidhur me shëndetësi
13	Ministria e Infrastrukturës	Bashkërendimi lidhur me projektet infrastrukurore
14	Ministria e punëve të brendshme	Bashkërendimi lidhur me çështje të sigurisë dhe riatdhesimit
15	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	Bashkërendimi lidhur me alokimin e tokave
16	Komunat e Kosovës	Bashkërendimi në projektet e nivelit lokal
17	Zyra komunale për komunitete dhe kthim	Bashkërendimi dhe raportet me nivelin lokal
18	OJQ e pavarura	Bashkërendimi lidhur me projektet për komunitetet
19	Grupet/Shoqatat e bizneseve, kulturore, arsimore etj.	Bashkërendimi lidhur me projektet për komunitetet
20	Mediat	Informimi dhe kampanjat informative

Tabela 6: Institucionet ndërkombëtare

Nr.	Palët me interes	Rëndësia
1	BE	Koordinimi për zbatimin e projekteve/ Bashkëfinancim i projekteve
2	IOM	Koordinimi për zbatimin e projekteve
3	UNHCR	Koordinimi për zbatimin e projekteve, monitorimin e zbatimit të politikave të kthimit; roli mbikëqyrës në procesin e kthimit
4	DRC	Koordinimi
5	UNDP	Koordinimi
6	UNKT	Koordinimi për bashkë-financim dhe / ose ndarjen e kostos
7	Ambasada e Britanisë së Madhe	Koordinimi për bashkë-financim dhe / ose ndarjen e kostos
8	Ambasada e Mbretërisë së	Koordinimi për bashkë-financim dhe / ose

	Norvegjisë	ndarjen e kostos
9	OSBE	Koordinimi
10	Ambasadat e huaja në Kosovë	Koordinimi
11	OJQ rajonale dhe ndërkombëtare	Koordinimi për bashkë-financim dhe / ose ndarjen e kostos dhe bashkëpunimit
12	Mediat rajonale dhe të huaja	Bashkërendimi për bashkërendim dhe informim

### E8. Sfidat dhe problemet e identifikuar

- Mungesa e të dhënave bazë mbi PZh në rajon Mali i Zi, Serbi dhe IRJM;
- Mungesa e të dhënave të sakta për PZh në Kosovë;
- Mungesa e një strategjie të shkruar mbi zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur;
- Mungesa e strategjisë së integritit institucional për të kthyer vullnetar;
- Mungesa e bazës ligjore për menaxhimin e proceseve për kategoritë e të kthyerve;
- Shtëpi të zbrazëta;
- Mos qëndrueshmëria e ndihmës për krijimin e të ardhurave;
- Mungesa e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale;
- Koordinimi i pamjaftueshëm në mes të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- Mungesa e ndarjes së tokës;
- Pamjaftueshmëria në bashkë - financimin e projekteve;
- Mungesa e infrastrukturës joadekuate të institucioneve arsimore dhe shëndetësore;
- Pamjaftueshmëria në përditësimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për kthim dhe komunitete në nivel qendror dhe lokal;
- Ndihma e pamjaftueshme për grupet e cënueshme të të kthyerve: të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara;
- Asistenca e pamjaftueshme për grupet e të kthyerëve romë, ashkali dhe egjiptian;
- Mungesa e monitorimit të zbatimit të strategjisë;
- Cilësia e pamjaftueshme e ndërtimit dhe nihmës socio - ekonomike.

### E9. Masat e rekomanduara

- Anketa për PZh në Kosovë për të identifikuar numrin e personave të zhvendosur në Kosovë;
- Hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për zgjidhje të qëndrueshme për PZh me theks të veçantë në ata që nuk kanë pronë dhe tokë të alokuar, për të marrur përsëri pronën dhe masat e riintegritit të të kthyerve;
- Hartimi i rregulloreve për procesin e kthimit (duke përfshirë riintegrimin) dhe protokollet e nevojshme;
- Përmirësimi i mekanizmave për përzgjedhjen e përfituesve nëpërmjet të cilit të gjithë të kthyerit do të trajtohen në mënyrë të barabartë;
- Përmirësimi i vlerësimit të kërkesave për ndihmë në gjenerimin e të ardhurave;

- Koordinimi me institucionet lokale dhe ndërkombëtare për zhvillimin ekonomik;
- Ofrimi i strehimit dhe asistencës socio - ekonomike për familjet dhe mbyllja e qendrave kolektive;
- Vlerësimi dhe adresimin e PZh-ve në vendbanime joformale;
- Koordinimi me institucionet qendrore dhe lokale për të gjetur zgjidhje për ndarjen e tokës për PZh sidomos për romë, ashkali dhe egjiptian;
- Forcimi i koordinimit në mes të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, veçanërisht në lidhje me zbatimin e projekteve për PZh dhe komuniteteve në fushën e arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës, punësimit dhe mirëqenies, bujqësia, prona, sipërmarrjeve të reja, siguri në bashkësi përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, etj;
- Azhurnimi i rregullt dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për kthimin dhe komunitete në nivel qendror dhe lokal;
- Rritja e fondeve për grupet e cenueshme: të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara;
- Rritja e fondeve për grupet nga radhët e romëve, ashkallijve dhe egjiptianëve sipas Strategjisë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian;
- Zhvillimi i një kornizë për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e zbatimit të strategjisë;
- Një monitorimin striktë i cilësisë së ndërtimit, ndihmsë së ofruar socio - ekonomike nga MKK-ja.

## F. OBJEKTIVAT

MKK, përmes këtij dokumenti strategjik identifikon katër (4) objektiva për të implementuar këtë strategji.

Objektivat e identifikuar në këtë dokument, janë zhvilluar në nën-objektiva dhe në aktivitete konkrete në Planin e Veprimit, në mënyrë që t'i mbulojnë të gjitha fushat e veprimit të MKK-së me qëllim që të adresohen nevojat e të kthyerve dhe të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Sipas mandatit të saj, MKK synon kthimin e qëndrueshëm dhe stabilizimin e komuniteteve, prandaj këto katër objektiva, në mënyrë direkte ose indirekte kontibudojnë në realizimin e këtij synimi.

Këto prioritete strategjike janë identifikuar bazuar në përvojën e MKK-së, analizën e impaktit të strategjisë së periudhës paraprake (2009-2013), informatave nga terreni, hulumtimit të zhvilluar nga MKK dhe ECMI si dhe me rekomandimet e ofruara.

### OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

1. Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit, personave të zhvendosur në: Serbi, Mal të Zi dhe IRJM;
2. Fuqizimin dhe stabilizimin e komuniteteve në Kosovë;
3. Hartimi dhe plotësimi i kornizës ligjore për komunitete, kthim dhe integrim;
4. Avancimi i sistemit të menaxhimit të brendshëm të MKK-së.

**Në vazhdim janë paraqitur objektivat, nën-objektivat dhe aktivitetet strategjike:**

**Shpjegimi për objektivin strategjik 1:** *Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda Kosovës dhe personave të zhvendosur në : Serbi, Mal të Zi dhe IRJM;*

*MKK përmes këtij objektiivi strategjik synon që të ofrojë ndihmë për gjetjen e zgjidhjeve afatëgjata për personat e zhvendosur brenda teritorit të Kosovës, personat e zhvendosur në Serbi, Mal të Zi, IRJM dhe fasilitimi i mbështetjes së refugjatëve të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë që jetojnë në Republikën e Kosovës. Kosova si shtet demokratik dhe multietnik, mundëson kthimin dhe jetesën e sigurt dhe prosperuese të të gjithë qytetarëve të saj në vendin e tyre të origjinës apo vendosjen e qëndrueshme në ndonjë lokacion tjetër brenda vendit. Përzgjedhja e kërkesave për kthim do të bëhet sipas kritereve ndërsa ndihma e ofruar do të përfshij: ndërtim të plotë dhe renovim të pjesërishëm të hapsirave të banimit, ndihma me pako ushqimore - higjienike, mobilje, dru zjarri, ndihma për gjenerim të të hyrave, punësim dhe projekte infrastrukturore. Një nga prioritetet e MKK-së për kthim për periudhën e implementimit të kësaj strategjie, mbetet përkrahja e të zhvendosurve nga qendrat kolektive dhe informimi i qytetarëve të interesuar për kthim për kushtet dhe kriteret e kthimit si dhe për të drejtat dhe obligimet e komuniteteve.*

### **Masat / Nën-Objektivat Strategjike**

- 1.1 Mbështetja e të gjithë personave të interesuar për kthim sipas procedurave dhe kritereve të MKK-së;
- 1.2. Zgjerimi i ndihmës për familjet e zhvendosur që jetojnë në qendrat kolektive dhe vendbanimet private;
- 1.3 Koordinimi në mes të MKK-së dhe institucioneve relevante përmes mekanizmave efektiv në aspektin e ofrimit të mundësive për ndarjen e tokës;
- 1.4 Forcimi i mekanizmave ekzistuese të informimit për kushtet dhe kriteret e kthimit, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e komuniteteve.

**Shpjegimi për objektivin strategjik 2:** *Fuqizimi dhe Stabilizimi i Komuniteteve në Kosovë;*

*Si vazhdimësi e procesit të kthimit, fuqizimi dhe stabilizimi i të gjitha komuniteteve në Kosovë është një ndër prioritetet e MKK-së. Me këtë synohet mbështetja e stabilizimit, riintegrimit dhe zhvillimit të qëndrueshmërisë ekonomike të komuniteteve. Për arritjen e këtij objekti planifikohet vazhdimësia e aktiviteteve si: shpërndarja e materialit ndërtimor për familjet në nevojë, përkrahja e projekteve që kanë për qëllim krijimin e gjenerimit të të ardhurave dhe mundësitë e punësimit, riintegrimit dhe stabilizimit të komuniteteve përmes përkrahje (perfshirje) edhe të shoqërisë civile.*

*Ky proces kompleks kërkon angazhim të institucioneve tjera përveç MKK-së, prandaj ky objektivi zëbërthet në nën-objektiva të cilat parashohin koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me institucione relevante për t'iu lehtësuar komuniteteve qasje në edukim, shëndetësi, shërbime tjera publike në komunat përkatëse. MKK-ja rëndësi të veçantë do tu kushtoj grupeve që konsiderohen të disfavorshme të të kthyerve: (femrat, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian).*

### **Masat / Nën-Objektivat Strategjike:**

- 2.1 Koordinimi me institucionet relevante për përmirësimin e kushteve për komunitetet;
- 2.2 Koordinimi me institucionet relevante për gjetjen e zgjidhjeve për vendbanimet joformale;
- 2.3 Mbështetja e përfituesve sipas udhëzuesit për kthim të qëndrueshëm;
- 2.4 Përkrahja për zhvillim ekonomik të komuniteteve në Kosovë;
- 2.5 Avancimi i ndihmës për OJQ-të dhe grupet e disfavorshme të të kthyerve dhe PZH-ve: të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara;
- 2.6 Avancimi i ndihmës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

### **Shpjegimi për objektivin strategjik 3: Hartimi dhe plotësimi i kornizës ligjore për komunitete, kthim dhe integrim;**

*Gjatë periudhës 2014-2018, MKK synon që të bëjë hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore. MKK-ja në pesë vitet e ardhshme synon që të bëjë identifikimin e nevojave për hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, dhe zbatimin e tyre. Qëllimi i këtij objekti është identifikimi i nevojave dhe hartimi i akteve ligjore që do të ndikonin në përmirësimin e procesit të kthimit dhe stabilizimit të qëndrueshëm të komuniteteve. Përveç hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore, MKK synon që të bëjë nxjerrjen e doracakut të nevojshëm në të cilët do të përfshihen kriteret të cilat kanë të bëjnë me procesin e kthimit, si dhe do të kenë ndikim të drejtëpërdrejtë në lehtësimin e informimit të komuniteteve. MKK është e përkushtuar që gjatë kësaj periudhe të krijoj një kornizë ligjore kompakte, e cila do të gjejë zbatim konkret gjatë këtij procesi.*

**Masat / Nën-Objektivat Strategjike:**

3.1 Hartimi, ndryshimi dhe plotësimi i i kornizës ligjore për komunitete, kthim dhe riintegrim ;

3.2 Krijimi i kornizës për monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe të akteve nën ligjore për Komunitete dhe Kthim.

**Shpjegimi për objektivin strategjik 4: *Avancimi i menaxhimit të brendshëm të MKK-ës;***

*Efikasiteti i menaxhmentit të brendshëm është shumë më rëndësi për të zbatuar ndryshimet e duhura dhe për të siguruar fonde të reja për MKK. Në këtë aspekt, vlerësimi i mekanizmave ekzistues të menaxhmentit, hartimi i politikave, azhurnimi i bazës së të dhënave dhe monitorimi, vlerësimi dhe raportimi janë parakushte për avancim të menaxhmentit të brendshëm.*

*Pasi që numri i kërkesave për asistencë është shumë i lartë dhe MKK me buxhetin e saj të limituar nuk është në gjendje që t'u përgjigjet të gjitha kërkesave të paraqitura. Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për asistencë në nivel të kënaqshëm, kjo strategji parasheh si objektiv rritjen e fondeve dhe iniciativave për bashkërendim me donatorë vendor dhe ndërkombëtar për të orientuar resurset në drejtim të duhur. Koordinimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare është esencial për të bashkërenditur në mënyrë efektive politikat dhe resurset në drejtim të arritjes së më shumë objektivave për ndihmesën e kthimit dhe komuniteteve. Implementimi i nën-objektivave do të zhvilloj identifikimin e nevojave për projekte, hartimin e projekteve si dhe procedurat pasuese të monitorimit, raportimit dhe mbarëvajtjes së implementimit.*

**Masat / Nën-Objektivat Strategjike:**

4.1 Konsolidimi i mekanizmave ekzistues për menaxhimin e përgjithshëm dhe në nivel departamenteve dhe divizioneve;

4.2 Krijimi i mekanizmave për komunitete dhe kthim(koordinim ndër - ministror, koordinimi brenda MKK-së dhe koordinim me donatorët dhe palët me interes vendorë, rajonalë dhe ndërkombëtarë);

4.3 Avancimi i mekanizmave të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit për cilësinë e zbatimit të aktiviteteve dhe projekteve për komunitete dhe kthim;

4.4 Funkcionalizimi, azhurnimi dhe raportimi i të dhënave nga baza e të dhënave, arkivimi qendror dhe shkembimi i te dhenave me palët me interes sipas ligjit në fuqi;

4.5 Vlerësimi dhe zhvillimi i projekteve për rritjen e fondeve dhe koordinimi me donatorë;

## G. ALTERNATIVAT E KONSIDERUARA

Në bazë të rekomandimeve, hulumtimit të gjendjes së komuniteteve në Kosovë përmes fokus grupeve, intervistave, pyetësorëve si dhe përvojës së MKK-së dhe partnerëve të saj, janë marrë në konsideratë disa alternativa për arritjen e objektivave strategjike. Alternativat që janë shqyrtuar me qëllim të zbatimit të Objektivave në kuadër të Strategjisë kanë ngërthyer nevojën për qasje gjithëpërfshirëse duke u bazuar në burimet ekzistuese në dispozicion.

Alternativa më e përshtatshme për arritjen e synimit të lehtësimit të procesit të kthimit, stabilizimit dhe integritit të komuniteteve në këtë fazë dhe në periudhën afatmesme është krijimi i mekanizmave të përmirësuar dhe thjeshtësuar. Parakusht kryesor për stabilizimin e komuniteteve dhe kthimin e qëndrueshëm është ofrimi i përkrahjes që përfshin: rindërtimin e shtëpive përfshirë këtu (rindërtimin e plotë dhe riparimet e vogla), ndihmat në ushqim, artikujt higjienik, mobile themelore, asistencë për zhvillim ekonomik, gjenerim të të hyrave, punësim si dhe përkrahja me materiale ndërtimore.

Si një alternativë e domosdoshme që duhet konsideruar është edhe zgjerimi i grupit të përfituesve të ndihmave gjatë kthimit dhe fokusimi në ndihma për familjet të cilat janë të shpërngulura dhe jetojnë në qendra kolektive me qëllim të gjetjes së një zgjidhje afatgjatë. Gjithashtu, parashihet fuqizimi i mekanizmave të informimit për kushtet dhe kriteret e kthimit si dhe një koordinim më i theksuar me institucionet përkatëse lidhur me përmirësimin e kushteve për shërbime publike: arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë.

Prioritet i kësaj strategjie do të jetë avancimi i ndihmës për grupet e disfavorshme të të kthyerve: të rinjtë, femrat, personat me aftësi të kufizuara dhe komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptian. Këto grupe të disfavorshme parashihet të jenë prioritet në procesin e përzgjedhjes të përfituesve dhe të hartimit/planifikimit të projekteve për stabilizimin e këtyre grupeve.

Një synim strategjik që i'a vlen të nënvizohet është evidentimi dhe nxjerrja e ligjeve dhe akteve nën-ligjore që duhet të plotësohen dhe ndryshohen. Poashtu, parashihet avancimi i mekanizmave monitorues, vlerësues dhe raportues të aktiviteteve, projekteve, për sigurimin e cilësisë së implementimit të projekteve.

Për përmbushjen e objektivave parashihet funksionalizimi dhe azhornimi i bazës së të dhënave dhe arkivimit në mënyrë që MKK të ketë informata të tilla që e rrisin efikasitetin e punës së të gjitha departamenteve, t'i përmbushë nevojat e të kthyerve dhe të ketë koordinim më të ngushtë me aktorët përkatës me qëllim që të mos mbivendosen shërbimet mbështetëse.

Parashikohet evidentimi i nevojave/projekteve nga brenda Ministrisë përmes ngritjes së kapaciteteve për bashkërendim të planeve dhe aktiviteteve me akterët tjerë vendor dhe ndërkombëtar si dhe zhvillimit të kapaciteteve për rritjen e fondeve dhe donacioneve.



Bashkërendimi me institucionet përkatëse përsa i përket ofrimit të mundësive për dhënie të tokës në shfrytëzim për ndërtim të hapësirave banuese si dhe të përmirësimit të kapacitetit për stimulim të zhvillimit të mëtejshëm ekonomik në Kosovë, duke siguruar mundësi të barabarta për zhvillim për të gjitha komunitetet, konsiderohet si alternativë tjetër.

Duke marrë parasysh që procesi i integrimi evropiane është prioriteti strategjik dhe nga më të rëndësishmit për Kosovën, plotësimi i kriterëve me theks të veçantë në procesin e kthimit dhe integritet të komuniteteve duhet të adresohet si çështje kyçe në kuadër të dokumentit strategjik.

Alternativat që janë shqyrtuar më qëllim të zbatimit të Objektivave në kuadër të Strategjisë kanë ngërthyer nevojën për qasje gjithëpërfshirëse bazuar në burimet ekzistuese në dispozicion.

Rreziqet e identifikuara mbetet një shqetësim përmes zbatimit të kësaj strategjie si: kontributet e donatorëve për disa nga aktivitetet që do të zbatohen që janë me rëndësi të madhe; por kjo varet nga gatishmëria e donatorëve; që nga MKK-ja ka një buxhet të kufizuar; mundësia e ndarjes së tokës varet nga aftësitë e komunës për të japin tokë; bashkë-financimi për projekte varet nga vullneti i palëve të interesuara për t'u angazhuar në këto aktivitete.

## H. QASJA E REKOMANDUAR

Strategjia synon të arrijë stabilizimin e komuniteteve me mekanizmat që konsiderohen të jenë më të mirët për realizimin e suksesshëm të kthimit të të gjithë personave të zhvendosur brenda vendit, si dhe personave të zhvendosur dhe refugjatëve në rajon. Për më tej, kjo strategji ka për qëllim stabilizimin e plotë të komuniteteve në mënyrë që ata të mund të ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre, të kenë qasje të plotë në shërbimet publike dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik. Në këtë drejtim, kjo qasje nuk është vetëm parakusht për kthim të qëndrueshëm, por edhe parakusht për të siguruar mirëqenien e shoqërisë në përgjithësi.

Strategjia është lehtësisht e zbatueshme për MKK-në dhe të gjithë aktorët e tjerë që do të punojnë në çështjet e kthimit dhe komuniteteve në pesë vitet e ardhshme, e cila përfshin:

- 1) Një plan të qartë veprimi;
- 2) Përcaktim të qartë të ndarjes së përgjegjësisë;
- 3) Mjetet financiare nga qeveria dhe donatorët;
- 4) Një shtrirje të qartë dhe të specifikuar të aktiviteteve;
- 5) Synime, objektiva, rezultate dhe aktivitete logjistikisht të ndërlidhura dhe të arritshme;
- 6) Tregues dhe pikësynime të qarta dhe të matshme;
- 7) Një plan të mirëpërcaktuar për monitorimin, vlerësimin, dhe raportimin duke përfshirë mekanizmat e mbledhjes së të dhënave.
- 8) Koordinimi me akterët lokal, regional dhe ndërkombëtar.



MKK-ja i kushton rëndësi krijimit të mekanizmave për thjeshtësimin e procesit të kthimit në bazë të standardeve të unifikuara, duke u nisur së pari nga zgjidhja e çështjeve të banimit që ka të bëjë me rindërtimin dhe ndërtimin e hapësirave banuese sipas standardeve të pranueshme. Kujdes i veçantë i kushtohet zgjerimit të grupeve të përfituesve prandaj MKK-ja ofron edhe mekanizmat mbështetës.

MKK do të ofroj mekanizma mbështetës për PZH të cilët dëshirojnë që të kthehen në vendet e tyre të origjinës apo vende tjera që nuk janë të origjinës, aty ku kanë pronën apo vend tjetër, në mënyrë që të sigurohet mbështetja për integrim në vendet e shpërnguljes apo tjetër vend brenda Kosovës dhe gjithashtu të sigurohet ofrimi i ndihmës për PZH të cilët nuk kanë fare pronë. Në pajtim me nevojat e paraqitura për shfrytëzuesit e momentit të qendrave kolektive, në të njëjtën kohë, MKK synon mbylljen e të gjitha qendrave kolektive dhe zgjidhjen e problemeve të strehimit kolektiv gjatë periudhës së këtij plani strategjik.

Duke u bazuar në nevojën për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim të personave të zhvendosur, kërkohet shtim i fondeve për ri-integrimin ekonomik dhe sigurimin e mundësive të barabarta për të gjitha komunitetet. Shtimi i fondeve është i nevojshëm për realizimin e synimeve për stabilizimin e komuniteteve dhe kthim të qëndrueshëm në Kosovë dhe për realizimin e programeve të ri-integrimit dhe realizimin e tërësishëm të projekteve të parapara nga Qeveria e Kosovës. Posaçërisht kërkohen fonde shtesë edhe për krijimin e mundësive të punësimit që i kontribuon kthimit të qëndrueshëm.

Qasja më e favorshme e rekomanduar në strategji orientohet në dy shtylla të rritjes së mjeteve financiare:

- Mjetet financiare në dispozicion nga buxheti i MKK-së dhe institucionet tjera qeveritare;
- Mjetet financiare nga donatorët;

## I. HAPAT E ARDHSHËM

MKK do të mbetet institucioni kryesor i Qeverisë së Republikës së Kosovës, përgjegjës për zbatimin e kësaj strategjie. MKK-ja do të vazhdojë të koordinojë përpjekjet në sektorin e kthimit dhe stabilizimit të komuniteteve. Gjatë periudhës së planifikimit të kësaj strategjie, MKK, siç thuhet edhe në objektivat e strategjisë do të kërkojë një qasje më realiste për kthimin që do të bazohet në nevojat e përfituesve.

Dokument plotësues i Strategjisë është Plani i Veprimit, i cili do të përfshijë një periudhë kohore prej tre vitesh, me mundësi rishikimi vjetor në varësi të përmbushjes së aktiviteteve të planifikuara për periudha të ndryshme kohore. Plani i Veprimit paraqet një përmbledhje e të gjitha dokumenteve të dizajnuara për të adresuar problemet e ndryshme të këtij procesi për zhvillimin e iniciativave të reja.

Plani i Veprimit i Strategjisë jep detaje mbi zbatimin e objektivave strategjike, afatet për arritjen e këtyre objektivave, institucionet përgjegjëse për implementim, treguesit e monitorimit dhe vlerësimin, kostot dhe bartësit e shpenzimeve për realizimin e aktiviteteve të planifikuara në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

Për zbatimin e aktiviteteve të pranuar nga të gjitha palët me interes, të cilët u konsultuan edhe në faza të ndryshme gjatë hartimit të draft strategjisë do të përfshihen në procesin e kthimit dhe stabilizimit të komuniteteve. Një çështje e rëndësishme është informacioni i vazhdueshëm dhe i përshtatshëm i PZH-ve në procesin e kthimit. Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, qeveritare dhe jo-qeveritare do të kontribuojë në arritjen e objektivave të përcaktuara në Strategji.

Në lidhje me monitorimin e zbatimit të strategjisë 2014-2018, do të ndërmerren këtahapa:

- Krijimi i mekanizmave për koordinimin ndër-ministror udhëhequr nga MKK-ja;
- Zhvillimi i një kornizë për monitorimin e zbatimit të strategjisë 2014-2018;
- Vlerësimi dhe raportimi mbi progresin e zbatimit të strategjisë.

Ky dokument strategjik do të ndihmojë MKK-në që të arrijë objektivat e saj lidhur me procesin e kthimit dhe stabilizimit të komuniteteve, duke menaxhuar me efikasitet resurset dhe duke forcuar bashkëpunimin me palët me interes.

## J. SHTOJCAT

### Shtojca A - Plani i Veprimit

### Shtojca B - Instrumentet Ligjore

## *Plani i veprimit për strategjinë për komunitete dhe kthim 2014-2016*

### *SHTOJCA A*

Plani i Veprimit është zhvilluar në bazë të objektivave të përcaktuara, dhe thekson në mënyrë të qartë masa konkrete për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara për secilin objektiv. Në përmbajtje, Plani i Veprimit reflekton katër objektiva dhe nën - objektivat të cilat MKK-ja planifikon të zbatojë, veprimet konkrete që shpiejnë në arritjen e objektivave; institucionet që duhet të përfshihen në procesin e kthimit, riintegritit dhe stabilizimit të komuniteteve dhe përgjegjësitë e tyre; periudha e nevojshme e kohës për të arritur objektivat, burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve dhe treguesve të matshëm për të realizuar çdo objektiv. Kjo strategji nuk do të krijoj implikime shtesë financiare për buxhetin e Kosovës, e gjitha kostoja financiare për zbatim do të mbulohet nga MKK-ja dhe donatorët.

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
<b>1. Objektiv Strategjik:</b> Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit, personave të zhvendosur në: Serbi, Mal të Zi dhe IRJM						
<b>Masa/Nënobjektiv Strategjik:</b> 1.1 Mbështetja e të gjithë personave të interesuar për kthim sipas procedurave dhe kritereve të MKK-së;						
1.1.1 Përkrahja për kthim në: rindërtimin e shtëpive (rindërtimin e plotë dhe riparimet e vogla), ndihmat në ushqim, artikujt higjienik, mobile themelore dhe zhvillim ekonomik	<p>a) 180 shtëpi të rindërtuara (rindërtimi i plotë dhe riparimet e vogla) me mjete financiare të MKK-së;</p> <p>b) 250 shtëpi të rindërtuara (rindërtimi i plotë dhe riparimet e vogla) me mjete financiare të MKK dhe BE RRK IV;</p> <p>c) Kthimi i 60 familjeve të</p>	MKK	Komunat dhe donatorët,	2014-2016	<p>a) MKK – 6 mil. €</p> <p>b) MKK – 2 mil. € /EU-RRK IV – 4 mil. € – 250 familje (2014-2016) -</p> <p>c) MKK /EU – 60 familje / MKK – 200.000.00 €/BE – 1.8 mil. € (vazhdim nga 2013-2015) ;</p> <p>d) BE – 1.53 mil. € / MKK – 170,000.00 €</p>	c) Kthimi përmes Programit për Mbështetje të Strehimit për të kthyerit nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Malit të Zi

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
	zhvendosura; d)Mbyllja e kampit në Leposaviq, ndihme për 46 familje.				- 46 familje (Kampi Leposaviq) (vazhdim nga 2013-2015);  Komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptas (vendbanimet informale të të zhvendosur)	
1.1.2 Miratimi i dizajneve të hapësirave të banimit, implementimi i ndërtimit dhe monitorimi-raportimi	Dizajnet e miratuara për hapësira të banimit	MKK	Donatorët	K2-K3, 2014-2016		

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
1.1.3 Vlerësimi dhe miratimi i kërkesave të përfituesve në bazë të kriterëve për mundësinë e marrjes së ndihmës me pako higjienike, gjëra ushqimore, jo-ushqimore, teknike e bardhë, mobilje;	a) 180 familje të përkrahura me: pako ushqimore dhe higjienike; b) 180 familje të përkrahura me: teknike të bardhë dhe mobile themelore.	MKK	Donatorët	2014-2016	a) 15,000.00 € b)200,000.00 €	
1.1.4 Vlerësimi dhe miratimi i kërkesave të përfituesve për mundësinë e marrjes së ndihmës për gjenerimin e të ardhurave dhe/apo gjetjen e punës	195 përfitues të përkrahur	MKK	Komunat, Donatorët	K2 - K4,2014-2016	390,000.00 €	
1.1.5Vlerësimi dhe miratimi i nevojës për projekte infrastrukturore në bashkëpunim ndërmjet nivelit qendror dhe lokal	90 projekte infrastrukturore të miratuara	MKK	MI, Komunat, Donatorët	K1 - K4,2014-2016	4.2 Mil €	

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.2. Vazhdimi i ndihmës për familjet e shpërngulura që jetojnë në qendra kolektive dhe vendbanime private</b>						
1.2.1 Përkrahja e familjeve të zhvendosura që jetojnë në qendra kolektive dhe vendbanime private	<b>Deri në 200</b> familje në qendrat kolektive të përkrahura	MKK	Donatorët	2014-2016		Buxheti varet nga donatorët
1.2.2 Bashkërendimi me institucionet qendrore dhe lokale për përcaktimin e lokacioneve për hapësira të ndërtimit dhe qasje në shërbime publike	Mbajtja e së paku katër takimeve në vit	MKK	/Institucionet qendrore dhe lokale, Donatorët	2014-2016		
1.2.3 Aplikimi për fonde për implementim	Fondet e siguruara deri në 200 familje	MKK	Donatorët	2014-2016		
1.2.4 Vlerësimi dhe miratimi i kërkesave të përfituesve potencial për ndihmë për zhvendosjen nga qendrat kolektive dhe vendbanimet private	Deri në 200 kërkesa të miratuara	MKK	Donatorët	2014-2016		

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.3</b> Koordinimi në mes të MKK-së dhe institucioneve relevante përmes mekanizmave efektiv në aspektin e ofrimit të mundësive për ndarjen e tokës						
1.3.1 Organizimi i takimeve koordinuese me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.	Deri në 4 takime brenda vitit	MKK	Institucionet vendore dhe ndërkombëtare	K1-K4, 2014-2016		
1.3.2 Bashkërendimi me nivelin qendror dhe lokal për miratimin e lokacioneve përkatëse	Numri i lokacioneve të miratuara	MKK	Institucionet vendore dhe ndërkombëtare	2014-2016		Miratimi i lokacioneve varet nga Komunitat
1.3.3 Vleresimi dhe miratimi i kërkesave të përfituesve për ndihmë për ndërtimin e hapsirave të banimit dhe ndihmë socio-ekonomike	Numri i kërkesave të përfituesve	MKK	Institucionet vendore dhe ndërkombëtare	2014-2016		Përkrahja e përfituesve varet nga donatorët
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.4</b> Forcimi i mekanizmave ekzistuese të informimit për kushtet dhe kriteret e kthimit, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e komuniteteve						
1.4.1 Fuqizimi i ekipit për informim dhe publikime për kthim	a) Deri në 3000 broshura të hartuara-publikuara, b) Deri në 30 debate dhe intervista në media lokale dhe 15 artikujve në media rajonale dhe atyre	MKK		2014-2016	a) 6,000.00 € b) 5,000.00 €	



Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
	ndërkombëtare					
1.4.2 Hartimi i planit operativ për informim për kthim dhe publikime	Plani operativ për informim i hartuar	MKK		K1-K2 2014		
1.4.8 Organizimi i fokusuar i vizitave shko-dhe-informo dhe shko-dhe-shiko.	Deri në 30 vizita	MKK	Donatorët	2014-2016	30,000.00 €	
<b>2. Objektivi Strategjik: Fuqizimi dhe Stabilizimi i Komuniteteve në Kosovë</b>						
<b>Masa/Nëobjektivi Strategjik: 2.1</b> Koordinimi me institucionet relevante për përmirësimin e kushteve për komunitetet						
2.1.1 Koordinimi dhe fuqizimi i mekanizmave për zhvillimin e projekteve në të gjitha fushat me interes për komunitetet	a) Mekanizmatë fuqizuar b) Deri në 15 projekte	MKK	Donatorët	2014-2016		
2.1.2 Ndihma në rregullimin e dokumenteve personale dhe të pronës për të zhvendosurit dhe komunitetet;	Lehtësimi i qasjes në dokumente personale dhe pronësore	MKK	Komunat, MPB, AKP	2014-2016		
<b>Masa/Nëobjektivi Strategjik: 2.2</b> Koordinimi me institucionet relevante për gjetjen e zgjidhjeve për vendbanimet joformale;						

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
2.2.1 Organizimi i takimeve koordinuese me institucionet qendrore, lokale dhe ndërkombëtare.	Deri në 2 takime koordinuese brenda vitit	MKK	Institucionet vendore dhe ndërkombëtare	2014-2016		
2.2.2 Pjesëmarrja në mekanizmat koordinues për alokim të tokës	a) Deri në 2 takime në vit	MKK	Institucionet vendore dhe ndërkombëtare	2014-2016		
2.2.3 Bashkërendimi me nivelin qendror dhe lokal për miratimin e lokacioneve përkatëse	a) Numri i lokacioneve të miratuara	MKK	Institucionet vendore dhe ndërkombëtare	2014-2016		Numri i përfituesve varet nga bashkëfinancimi
2.2.4 Përzgjedhja e kërkesave të përfituesve për ndihmë.	a) Numri i kërkesave të përfituesve	MKK	Institucionet vendore dhe ndërkombëtare	2014-2016		Numri i përfituesve varet nga bashkëfinancimi
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.3</b> Mbështetja e përfituesve sipas udhëzuesit për kthim të qëndrueshëm						
2.3.1 Organizimi i takimeve koordinuese me institucionet qendrore, lokale dhe ndërkombëtare.	Deri në 2 takime koordinuese ne vit	MKK	Institucionet vendore, ndërkombëtare			Koordinimi për shmangien e mbivendosjes së ndihmës
2.3.2 Vlerësimi dhe miratimi i kërkesave të përfituesve në bazë të kriterëve për mundësinë e marrjes së ndihmës: material ndërtimor, pako higjienike, gjëra	a) 750 familje të përkrahura me material ndërtimor; b) 720 familje të	MKK		2014-2016	a) 4.5 Mil € b) 60,000.00 €	

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
ushqimore, jo-ushqimore, teknikë e bardhë, mobilje, dhe dru zjarri;	përkrahura me: pako ushqimore dhe higjienike;  c) 90 familje të përkrahura me: teknikë të bardhë dhe mobile themelore; d) 180 familje të përkrahura me dru zjarri për ngrohje.				c) 100,000.00 €  d) 60,000.00 €	
<b>Masa/Nënobjekti Strategjik: 2.4 Përkrahja për zhvillim ekonomik të komuniteteve në Kosovë</b>						
2.4.1 Organizimi i takimeve koordinuese me institucionet qendrore, lokale dhe ndërkombëtare.	Deri në 4 takime koordinuese brenda vitit	MKK	ZKM; MZHE,MTI, MBZHR, MPMS,KK. Donatorët	2014-2016		
2.4.2 Vlerësimi dhe miratimi i projekteve të përbashkëta për zhvillim ekonomik dhe gjenerimin e të ardhurave për komunitetet;	Numri i projekteve	MKK	ZKM, MZHE,MTI, MBZHR, MPMS,KK, Donatorët	2014-2016		Varet nga mbështetja e donatorëve
<b>Masa/Nënobjekti Strategjik: 2.5 Avancimi i ndihmës për OJQ-të dhe grupet e disfavorshme të të kthyerve dhe PZH-ve: të rinjtë, femrat dhe personat me aftësi të kufizuara</b>						

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
2.5.1 Vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve për OJQ-të dhe grupet e disfavorshme	Deri në 45 projekte	MKK	Institucionet vendore dhe donatorët	2014-2016	300,000.00 €	
2.5.2 Prioritetizimi i përzgjedhjes së përfituesve nga grupet e disfavorshme	Deri 15 përfitues	MKK	Komunat dhe Donatoret	2014-2016		Një pjesë nga donatorët dhe një pjesë nga numri i përgjithshëm i përfituesve
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.6 Avancimi i ndihmës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian</b>						
2.6.1 Vlerësimi dhe përzgjedhja e projekteve për përfituesit nga grupet e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian	Deri në 45 projekte	MKK	Institucionet vendore dhe donatorët	2014-2016	300,000.00 €	
2.6.2 Prioritetizimi i përzgjedhjes së përfituesve nga grupet e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian	Deri 15përfitues	MKK	Komunat dhe Donatoret	2014-2016		Një pjesë nga donatorët dhe një pjesë nga numri i përgjithshëm i përfituesve
<b>3. Objektivi Strategjik: Hartimi dhe plotësimi i kornizës ligjore për komunitete, kthim dhe integrim</b>						
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.1 Hartimi, ndryshimi dhe plotësimi i i kornizës ligjore për komunitete, kthim dhe riintegrim</b>						
3.1.1 Hartimi i kornizës ligjore për PZHBV dhe vendosja e MKK-së	Korniza ligjore e hartuar	MKK	ZKM, ML, Institucionet ndërkombëtare	2014-2015	30,000.00 €	

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
si pikë qendrore						
3.1.2 Hartimi dhe amandamentimi i kornizes ligjore ne fushen e kthimit dhe integritimit	Deri në 5 akte ligjore	MKK	ZKM, ML, Institucionet ndërkombëtare	2014-2016	50,000.00 €	
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.2</b> Krijimi i kornizës për monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe të akteve nën ligjore për Komunitete dhe Kthim						
3.2.1 Themelimi i komisionit për monitorimin e zbatimit të kornizës ligjore	Komisioni i themeluar	MKK		K1 2014		
3.2.2 Hartimi i kornizës për monitorim të zbatimit	Korniza e hartuar	MKK		K2 2014		
3.2.3 Raportimi mbi zbatimin e kornizës ligjore	2 raporte të paraqitura brenda vitit	MKK		2014-2016		
<b>4. Objektivi Strategjik:</b> Avancimi i menaxhimit të brendshëm të MKK-së						
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.1</b> Konsolidimi i mekanizmave ekzistues për menaxhmenin e përgjithshëm dhe në nivel të						

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
<b>departamenteve dhe divizioneve</b>						
4.1.1 Formimi i komisionit për konsolidimin e menaxhmentit të brendshëm	Komisioni i formuar	MKK		K1 2014		Te shiqohet Rregllorja për sistematizim të vendeve të punës
4.1.2 Konsolidimi i mekanizmave për hartimin e politikave dhe ndërlidhjes së detyrave ndërmjet shërbyesve civil dhe personelit politik	Mekanizmat e konsoliduar	MKK		K4 2014		
4.1.3 Hartimi i raportit me analiza dhe rekomandime për konsolidimin e menaxhmentit	Raporti i hartuar	MKK		K4 2014		
4.1.4 Miratimi i rekomandimeve dhe implementimi	a) Rekomandimet e miratuar b) Implementimi i rekomandimeve	MKK		2015		
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.2 Krijimi i mekanizmave për komunitete dhe kthim(koordinim ndër - ministror, koordinimi brenda MKK-së dhe koordinim me donatorët dhe palët me interes vendorë, rajonale dhe ndërkombëtarë)</b>						
4.2.1 Krijimi dhe funksionalizimi i mekanizmave për koordinim ndërministror, me donator dhe palët me interes	Komisioni i themeluar	MKK	ZKM, ML	2014		

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
4.2.2 Përcaktimi i formës dhe caktimi i zyrtarëve përgjegjës për vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të strategjisë 2014-2018	a) Forma e përcaktuar b) Zyrtarët e caktuar	MKK	ZKM, ML	2014		
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.3</b> Avancimi i mekanizmave të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit për cilësinë e zbatimit të aktiviteteve dhe projekteve për komunitete dhe kthim						
4.3.1 Fuqizimi i mekanizmave të brendshëm për monitorim, vlerësim dhe raportim të cilësisë së implementimit;	Mekanizmat e fuqizuar	MKK		2014-2016		
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.4</b> Funkcionalizimi, azhurnimi dhe raportimi i të dhënave nga baza e të dhënave, arkivimi qendror dhe shkëmbimi i të dhënave me palët me interes sipas ligjit në fuqi						
4.4.1 Funkcionalizimi i bazës së të dhënave për të zhvendosurit	Baza e të dhënave për të zhvendosurit e funksionalizuar	MKK		2014		
4.4.2 Caktimi i nëpunësve përgjegjës për menaxhimin dhe plotësimin dhe shkëmbim të të dhënave nga databaza	Nëpunësit e caktuar	MKK		2014		

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
4.4.3 Vendosja e formatit për pranim-dorëzim të të dhënave në një arkivë qendrore	Formati i përcaktuar	MKK		2014		
4.4.4 Vlerësimi i nevojës për trajnime lidhur me bazën e të dhënave	Trajnime të caktuara	MKK	IKAP/Donatorët	2014		
4.4.5 Sigurimi i fondeve të nevojshme për funksionalizimin e bazës së të dhënave	Fondet e siguruar	MKK	Donatorët	2014		Varet nga funksionalizimi i bazës së të dhënave
4.4.6 Mbledhja e të dhënave dhe profilizimi i PZH-ve	Raporti për profilizimin e PZH-ve	MKK	Institucionet vendore dhe Ndërkombëtare	2014	80,000.00 €	Varet nga mbështetja e donatorëve
<b>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.5 Vlerësimi dhe zhvillimi i projekteve për rritjen e fondeve dhe koordinimi me donatorë</b>						
4.5.1 Formimi i komisionit të brendshëm për rritje të fondeve	Komisioni i formuar	MKK		2014-2016		
4.5.2 Caktimi i nëpunësve përgjegjës për projekte dhe	Nëpunësit e caktuar	MKK		2014-2016	30,000.00 €	



Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
stimulimit përkatës financiar						
4.5.3 Hartimi i planit dhe projekteve dhe aplikimi për fonde	Plani për projekte i hartuar	MKK		2014-2016		
4.5.4 Identifikimi i projekteve për koordinim me donator vendor dhe ndërkombëtarë	Projektet e identifikuar	MKK	ZKM-ZÇK, ML, Donatorët	2014-2016		

## Shtojca B INSTRUMENTET JURIDIKE

### Instrumentet juridike vendore

Kushtetuta e Kosovës, 15 Qershor 2008;

Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës 2008/03-L047 nga 15.06.2008;

Ligji Nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 29 / 27 Dhjetor 2011, Prishtinë);

Ligji Nr. 04/L-017 për ndihmë Juridike Falas, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 03/22 Shkurt 2012, Prishtinë);

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti III / Nr. 27/03 Qershor 2008);

Ligji Nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 76 / 10 Gusht 2010);

Ligji Nr. 04/ L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 03/L221 dhe Nr. 04/L-116;

Ligji Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 82 / 21 Tetor 2010);

Ligji Nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 74 / 20 Korrik 2010);

Ligji Nr. 02/L-52 Mbi Edukimin Parashkollor, (Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: Viti I / Nr. 1 / 01 Qershor 2006);

Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, (Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: VITI II / Nr. 10 / 01 Mars 2007);

Ligji Nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare, (Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë :Viti II / Nr. 12 / 01 Maj 2007);

Ligji Nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 26 / 02 Qershor 2008);

Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen locale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 28 / 04 Qershor 2008);

Ligji Nr. 03/L-068 për arsimin në komune republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 30 / 15 Qershor 2008);

Ligji Nr. 03/L-022 për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të Përhershme, (Gazeta Zyrtare e republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 37 / 10 Shtator 2008);

Ligji Nr. 02/L-121 për vendbanimin dhe vendqëndrimin, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 40 / 15 Tetor 2008);

Ligji Nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të

Kufizuara, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti IV / Nr. 47 / 25 Janar 2009);

Ligji Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti IV / Nr. 57 / 04 Gusht 2009);

Ligji Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 70 / 31 Maj 2010);

Ligji Nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 88 / 25 Nëntor 2010);

Ligji Nr. 03/L-212 i punës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010);

Ligji Nr. 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 26 / 25 Nëntor 2011, Prishtinë);

Ligji Nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetror, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 02 / 20 Janar 2012, Prishtinë);

Ligji Nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 03 / 22 Shkurt 2012, Prishtinë);

Ligji Nr. 04/L-088 për arkivat shtetërore, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 04 / 19 Mars 2012, Prishtinë);

Ligji Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 35 / 17 Dhjetor 2012, Prishtinë).

Ligji Nr. 2004/ 3 Kundër Diskriminimit, (Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: Viti II / Nr. 14 / 01 Korrik 2007);

Ligji Nr. 2004/2 për Barazi Gjinore, (Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: Viti II / Nr. 14 / 01 Korrik 2007) ;

Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 14 / 9 Shtator 2011, Prishtinë);

Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 17 / 16 Shtator 2011, Prishtinë);

Ligji Nr. 04/-L-025 për Nisma Legjislative, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 23 / 26 Tetor 2011, Prishtinë);

Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 13 / 07 Maj 2013, Prishtinë);

Ligji Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 26 / 02 Qershor 2008);

Ligji Nr. 04/ L-059 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 26 / 25 Nëntor 2011, Prishtinë);

Ligji Nr. 04/L-061 Për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e banimit, (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Nr. 01/12 Janar 1012);

Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të posaqme të banimit, (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/viti V / Prishtinë: Nr. 67/29 Mars 1012);

Rregullore Nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 15/12 Shtator 2011, Prishtinë);

Rregullore Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, (Gazeta Zyrtare e Republikës / Nr.1/ 18 Prill 2011, Prishtinë);

Rregullore Nr. 07/2011 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive;

Rregullore Nr. 01/2012 për Këshillin e Drejtorëve të Departamenteve Ligjore;

Rregullore Nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim;

Rregullore Nr. 09/2012 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Shtetërore;

Rregullore Nr. 40/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, dt. 10 Janar 2013;

Rregullore e brendshme Nr. 01/2013 për Menaxhimin dhe Implementimin e Projekteve Kapitale të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, dt. 17 Qershor 2013;

Rregullore për Financimin e Projekteve të OJQ-ve për Zhvillimin dhe Stabilizimin e Komuniteteve Nr. 02/2012, dt. 28 Mars 2012;

Rregullore e Brendshme Nr. 04/2011 për Përcaktimin e Kritereve mbi Aktivitetet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, dt. 29 Gusht 2011;

Rregullore Nr. 04/2012 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores së Brendshme Nr. 04/2011 për Përcaktimin e Kritereve mbi Aktivitetet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, dt. 29 Mars 2012;

Letra e Kryeministrit për alokimin e tokave, dt. 06 Prill 2010.

Udhëzuesi për Zbatimin e Përkrahjes për Kthim, dt. 26 Mars 2012.

## **Instrumentet juridike ndërkombëtare**

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

dhe Protokollet e saj;

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;

Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore,

Jonjerëzore dhe Poshtëruese;

Parimet për rikthimin e Objekteve të Strehimit dhe Pronës Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur, Parimet nga Pinheira (2005);

Karta evropiane për gjuhët rajonale apo të pakicave (1994);

Karta shoqërore Evropiane- rishikuar (1996) e cila është nënshkruar po ende nuk është ratifikuar

Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe degradimit çnjerëzor ose trajtimit ndëshkues (1987);

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, Hyrë në fuqi: me 3 janar 1976,

Deklarata e Bolonjës në Hapësirën Evropiane për Arsim të Lartë, "Deklarata e Bolonjës" (1999)

Konventa Evropiane për Njohjen Akademike të Kualifikimeve Universitare (1959);

Konventa e Këshillit Evropian për Njohjen e Diplomave për hyrjen në Universitete (1953) dhe protokollet e saj (1964);

Konventa Evropiane mbi Njohjen e Ciklit të studimit Universitar (1956);

Konventa Evropiane mbi Njohjen e Ciklit të studimit Universitar (1990);

Konventa Evropiane për Njohjen e Kualifikimeve të Edukimit të Lartë brenda Rajonit Evropian (1999);

Konventa Evropiane për Njohjen e Kualifikimeve të Edukimit të Lartë brenda Rajonit Evropian (1979);

Zona Evropiane e Arsimit të Lartë, Qëllimi i zbatimit, komunikata e Konferencës Europiane të Ministrave Përgjegjës për Arsimin e Lartë, Bergen (2005);

Protokolli fakultativ së bashku me Konventës për zhdukjen e të gjitha llojeve të diskriminimit ndaj grave(2000);

Implementimi i Euro Hapësirës për Arsim të Lartë, komunikatë e Konferencës së Ministrave për Edukim të Lartë Berlin (2003);

Rezoluta për fuqizimin dhe bashkëpunimin e Arsimimit dhe Specializimit Profesional (2002);

Deklarata e unifikuar për harmonizimin e Sistemit Evropian të Strukturës së Arsimit të Lartë, Deklarata e Sorbonës (1998);

Marrëveshjet ndërkombëtare (bilaterale) për siguri shoqërore nga konventa e Gjenevës I-IV në mbrojtjen e viktimave të luftës (1949) dhe Protokollet shtesë I-II (1977);

Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijëve (1989) ;

Konventa e KB për të Drejtat dhe Statusin e Refugjatëve (1951) dhe Protokollet Shtesë (1967);

Konventa e KB për mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Emigrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre (1990);

Konventa e KB kundër Diskriminimit në Arsimim (1960);

Konventa e KB kundër Torturës dhe proceduarve tjera mizore, jo-humane dhe ndëshkimeve (1984);

Konventa ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (1968);

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, Hyrë në fuqi: 23 mars 1976, Parimet udhëheqëse për Zhvendosjen e Brendshme (1998).

Parimet udhëzuese të KB-së për personat e zhvendosur brenda vendit (Shtator 2004).